VENDIM
Nr. 181, datë 30.3.2022

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS, SHIJAK, LEZHË DHE KRUJË

(ndryshuar me VKM-në nr. 778, datë 12.12.2022, nr. 690, datë 6.12.2023; nr. 359, datë 5.6.2024)
(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, "Për buxhetin e vitit 2022", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 4 254 481 452 (katër miliardë e dyqind e pesëdhjetë e katër milionë e katërqind e tetëdhjetë e një mijë e katërqind e pesëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, nga bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë, për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat) dhe njësive individuale të banimit, të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) për Bashkinë Tiranë, në masën 1 166 365 230 (një miliard e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e dyqind e tridhjetë) lekë pa TVSH;

b) për Bashkinë Durrës, në masën 2 419 555 918 (dy miliardë e katërqind e nëntëmbëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë) lekë pa TVSH;

c) për Bashkinë Shijak, në masën 30 628 807 (tridhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e tetëqind e shtatë) lekë pa TVSH;

ç) për Bashkinë Lezhë, në masën 136 176 130 (njëqind e tridhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH;

d) për Bashkinë Krujë, në masën 501 755 367 (pesëqind e një milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2022, në masën 850 896 290 (tetëqind e pesëdhjetë milionë e tetëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e dyqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, dhe i transferohet bashkive Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë, në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi, në masën 233 273 046 (dyqind e tridhjetë e tre milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tre mijë e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH;

b) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 483 911 184 (katërqind e tetëdhjetë e tre milionë e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e njëqind e tetëdhjetë e katër) lekë pa TVSH;

c) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 6 125 761 (gjashtë milionë e njëqind e njëzet e pesë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH;

ç) Bashkisë Lezhë i transferohet fondi, në masën 27 235 226 (njëzet e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e pesë mijë e dyqind e njëzet e gjashtë) lekë pa TVSH;

d) Bashkisë Krujë i transferohet fondi, në masën 100 351 073 (njëqind milionë e treqind e pesëdhjetë e një mijë e shtatëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

2/1. Përveç përcaktimeve të bëra në shkronjat "b" dhe "c", të pikës 2, të këtij vendimi ,përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, për bashkitë Durrës dhe Shijak, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi, në masën 50 812 754 (pesëdhjetë milionë e tetëqind e dymbëdhjetë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar;

b) Bashkisë Shijak i transferohet fondi, në masën 24 503 046 (njëzet e katër milionë e pesëqind e tre mijë e dyzet e gjashtë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar.

2/2. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2023, në masën 1 994 584 758 (një miliard e nëntëqind e nëntëdhjetë e katër milionë e pesëqind e tetëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2023, dhe u transferohet bashkive Durrës, Lezhë dhe Krujë në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) për Bashkinë Durrës, në masën 1 490 187 768 (një miliard e katërqind e nëntëdhjetë milionë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH;

b) për Bashkinë Lezhë, në masën 107 654 732 (njëqind e shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH;

c) për Bashkinë Krujë, në masën 396 742 258 (treqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e shtatëqind e dyzet e dy mijë e dyqind e pesëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH.

2/3. Përdorimin e fondit të rindërtimit, për vitin 2024, në masën 1 079 695 259 (një miliard e shtatëdhjetë e nëntë milionë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e dyqind e pesëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2024, dhe u transferohet bashkive Tiranë dhe Durrës në formën e transfertës së pakushtëzuar, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Për Bashkinë Tiranë, në masën 711 979 470 (shtatëqind e njëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e katërqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH;

b) Për Bashkinë Durrës, në masën 367 715 789 (treqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind e pesëmbëdhjetë mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.

3. *Bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë caktohen si njësi zbatuese, sipas dispozitave të këtij vendimi.*

4. Ngarkohen zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe bashkitë Tiranë, Durrës, Shijak, Lezhë dhe Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj